



REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		20/05/2025	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	400/01	18482	

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT
Zyra e Kryetarit



Për : Drejtorët-Mbajtësit e buxheteve

Nga: Kushtrim Bajraktari, ZK

Lënda: QARKORJA INTERNE BUXHETORE KOMUNALE 2026/01

PËRGATITJA E PLANIFIKIMIT TË PRIORITETEVE PËR BUXHETIN E DREJTORATEVE –ZYRËVE KOMUNAL 2026-2028

1. Qëllimi

Qëllimi i kësaj qarkoreje buxhetore është të njoftojë mbajtësit e buxheteve komunale rreth informatave që kërkohen dhe orarit kohor për kompletimin e procesit të planifikimit të prioriteteve nga drejtoratet-zyrë të komunale, për periudhën 2026-2028.

Në kuadër të qeverisjes lokale, buxheti përfshin një plan të përgjithshëm për arritjen e synimeve dhe objektivave sipas drejtorateve-zyrëve komunale (programe buxhetore). Procesi buxhetor ka të bëjë me ndarjen e resurseve për programet dhe shërbimet e caktuara, prandaj konsiderohet si një nga aktivitetet më të rëndësishme të institucionit qeverisës.

Një proces buxhetor i integruar mirë rezulton me vendime më të mira financiare duke ndikuar kështu pozitivisht në funksionimin e përgjithshëm të institucionit. Planifikimi i shpenzimeve të cilat janë më efektive në realizimin e objektivave, ka për synim arritjen e vlerës më të madhe për fondet e shpenzuara. Në këtë drejtim, përfshirja e zyrtarëve të ndryshëm- punonjësve të programeve buxhetore dhe të qytetarëve- publikut në përgjithësi, ndihmon në pasqyrimin e nevojave esenciale të hisedarëve në fushën e caktuar.

Aspekti teorik i buxhetimit paraqet planin financiar, i cili specifikon të hyrat dhe shpenzimet për një periudhë të caktuar kohore, në këtë rast për periudhën 2026-2028. Me procesin buxhetor vlerësohen nevojat kundrejt mundësive në dispozicion.

2. Sfondi

Me procesin e ri buxhetor kërkohet që buxheti komunal të zhvillohet sipas Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale (KAB-i Komunal). Qasja e KAB-it, kërkon që komuna të shqyrtojë më për së afërmi nevojat dhe të bëjnë caktimin e prioriteteve për alokimet buxhetore, për të siguruar pajtueshmërinë me objektivat e saj ekonomik, fiskale e sociale. Planifikimi i prioriteteve nga drejtoratet-zyrë të komunale, do t'u ofrojë mundësinë menaxherëve të programeve që të identifikojnë propozimet për shpenzime të prioritetit të lartë, bashkë me kursimet potenciale në programet e prioritetit të ulët, apo me performancë të dobët, para se të bëhet përcaktimi i kufijve

final të buxhetit për secilin program. Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës duhet të jenë synimi kryesor. Gjatë muajve maj-qershor 2025, Drejtoria për Buxhet dhe Financa në bashkëpunim me drejtoratet tjera do të përgatis Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale (KAB-in), në të cilën theksohet prioriteti për buxhetin 2026-2028.

Këto prioritete janë:

- zhvilloi, promovoi dhe rigjeneroi infrastrukturën lokale,
- përmirësoi ambientin për të jetuar,
- përmirësoi sigurinë dhe shëndetësinë e qytetarëve,
- avancim në arsim, kulturë dhe sport,
- ofroi mjete për nevojtarët, shërbime sociale dhe të dëmtuarit dhe
- përkrah dhe zhvilloi biznesin dhe aftësitë individuale të talentëve, etj.

Drejtoratet- zyrët komunale duhet t'i shfrytëzojnë këto prioritete të larta si udhërrëfyes në përgatitjen e rishikimit të prioritetëve të tyre.

3. Shqyrtimi i prioritetëve të drejtorateve-zyreve komunale

Nga të gjitha drejtoratet- zyret, kërkohet të bëjnë planifikimin e programeve të tyre dhe prioritetëve të shfaqura në kontekst të prioritetëve buxhetorë të komunës (shih më lartë).

Ky planifikim i prioritetëve do t'u ofrojë mundësinë vendimmarrëseve (Kuvendit të Komunës dhe Komitetit për Politikë dhe Financa) që të bëjnë shqyrtimin e propozimeve të shkurtra nga menaxheret në një fazë të hershme dhe të identifikojnë ato propozime për të cilat do të kërkohet vlerësimi më i hollësishëm në dorëzimet e plotë buxhetore. Si të tilla, vetëm informata të shkurtra dhe arsytime kërkohen gjatë planifikimit të prioritetëve.

Formati për kompletimin e planifikimit buxhetor (kërkesat buxhetore), është pjesë e kësaj qarkoreje.

Bazuar në Qarkoren Buxhetore Nr:2026/01 të lëshuar nga MFPT-ja, planifikimi i shpenzimeve buxhetore do të bëhet sipas metodës së Buxhetimit Programor. Metoda e B.P, kërkon që buxheti të planifikohet për nga funksioni i shpenzimeve në programe-nënprograme të përcaktuara me Statutin e Komunës, sipas skemës organizative të organizatës buxhetore; për nga klasifikimi ekonomik, shpenzimet do të planifikohen në 5 (pesë) kategori kryesore ekonomike të shpenzimeve, në pajtim me rregullat financiare për shpenzimet (SIMFK) të nxjerra nga Thesari, si vijon:

1. Paga dhe Shtesa,
2. Mallra dhe Shërbime,
3. Shpenzime të Shërbimeve Komunale,
4. Subvencione-Transfere dhe
5. Investime Kapitale.

Në parim nuk do të ketë rritje të punësimit në sektorin publik.

Për **kalkulimin e pagave** për vitin 2026 duhet të merret për bazë për llogaritje të pagave muaji mars 2025 duke përfshirë rritjen e planifikuar të koeficientit për 0.5 dhe për puntorët aktual duhet shumëzuar me 12muaj. Ndërsa për punëtorët e papunësuar duhet përlogaritur paga mesatare dhe duhet buxhetuar vetëm 40%, brenda kufizimeve buxhetore.

Mallra dhe Shërbime- Organizatave buxhetore do t'i mundësohet financimi në fushat e rëndësishme dhe të domosdoshme. Organizatat buxhetore duhet të identifikojnë burimet brenda skenarëve bazë të tyre nga ato fusha me performancë jo të mirë, ose që nuk janë në përputhje të mjaftueshme me prioritetet e nivelit të lartë të Qeverisë **Shpenzimet e Shërbimeve Komunale** pritet të kenë pjesëmarrje përafërsisht të njëjtë në buxhet me vitin 2025.

Subvencionet dhe Transferet: Në kuadër të kësaj kategorie do të vazhdohet me ndarjen e mjeteve për zbatimin e skemave sociale, subvencioneve në bujqësi si dhe politikat e reja tani më të aprovuara.

Investimet kapitale përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve të përgjithshme dhe në periudhën afatmesme pritet të përfaqësojnë rreth 26% të shpenzimeve totale.

Përparësi për financim duhet të kenë projektet në vazhdim që janë inicuar në vitet paraprake dhe ato të cilat janë në harmoni të plotë me prioritetet e Komunës.

Shërbimet sociale rezidenciale duhet të financohen nga Granti i Përgjithshëm në vlerë prej 230,000.00€ për vitin 2026, 200,000.00€ për vitin 2027 dhe 200,000.00 € për vitin 2028.

Duhet pas parasysh se projektet e reja duhet të caktohen në përputhje me Udhëzimin administrative për kriteret përzgjedhëse të projekteve kapitale.

Kufijtë buxhetor për investime kapitale nëpër organizata buxhetore janë indikativ dhe Qeveria mban të drejtën t'i ndryshojë ata varësisht nga arsyeshmëria e projekteve që propozohen nga organizatat buxhetore.

Gjatë kësaj periudhe, pritet implementimi i projekteve kapitale bazuar në një listë prioritetesh që përmban projekte me ndikim në përmirësimin e infrastrukturës publike, dhe përmirësimin e kushteve në arsim, sistemin social dhe atë shëndetësor.

Qëllimi i listës është të ndihmojë dhe të inkurajojë caktimin e prioriteteve dhe (ri-caktimin e tyre) për resurset buxhetore në programet që kanë si synim plotësimin e objektivave më të rëndësishme fiskale e sociale të Komunës.

Gjatë zhvillimit të buxhetit të propozuar nga drejtoratet-zyret, dhe kërkesave për ndarjen buxhetore, duhet të merret parasysh Deklarata e Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë 2026-2028.

Burimet e financimit për sektorë sipas Q.B-2026/01 të lëshuar nga MFPT, janë si vijonë:

Administrata	Granti i Qeverisë	Të hyrat vetanake	Totali
2026	9,540,816.00	2,184,199.00	11,725,015.00
2027	10,274,195.00	2,338,150.00	12,612,345.00
2028	11,096,836.00	2,340,461.00	13,437,297.00
			37,774,657.00

Arsimi	Granti i Qeverisë	Të hyrat vetanake	Totali
2026	9,242,523.00	55,000.00	9,297,523.00
2027	9,519,799.00	60,000.00	9,579,799.00
2028	9,805,393.00	65,000.00	9,870,393.00
			28,747,715.00

Shëndetësia	Granti i Qeverisë	Të hyrat vetanake	Totali
2026	2,451,995.00	30,000.00	2,481,995.00
2027	2,525,555.00	32,000.00	2,557,555.00
2028	2,601,322.00	34,000.00	2,635,322.00
			7,674,872.00

Gjithsej Buxheti Komunal :

-Viti 2026= 23,504,533.00 €,

-Viti 2027= 24,749,699.00 €,

-Viti 2028 =25,943,012.00 €.

4. Veprimet që kërkohen

1. Përgatitja e vlerësimeve të prioriteteve 2026-2028 për secilin program-nënprogram udhëhiqet nga secili drejtor i programit-nënprogramit, ku caqet e shpenzimeve përcaktohen për tri vite (2026-2028).

Planifikimi i bazuar në performancën e programit-nënprogramit është i obligueshëm. Programet buxhetore duhet të prezantojnë indikatorët e performancës të përmblodhur sipas objektivave përkatëse në nivel të organizatës buxhetore, bazuar në nenin 21 të Ligjit Nr.03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Duke vepruar sipas Ligjit për Barazi Gjinore Nr.05/L-020 (2015) programet buxhetore janë përgjegjëse për „përfshirjen e buxhetimit gjinor në të gjitha fushat, si një instrument i nevojshëm për të garantuar që parimi i barazisë gjinore të respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe caktimin e burimeve” (Neni 5.1.5). Për këtë arsye, programet buxhetore duhet të bëjnë të dukshme efektet e shpenzimeve publike në barazinë gjinore në buxhetin vjetor për vitin 2026. Kjo do të kontribuon gjithashtu në rritjen e efektivitetit dhe transparencës së menaxhimit të financave publike.

2. Kompletimi i formularit, duke specifikuar prioritetet për periudhën 2026-2028,
3. Buxheti i programit duhet të bazohet në projekte konkrete për kategori të shpenzimit,
4. Kryetari i Komunës (ZKA) dhe ZKF-ja, mbajn takime konsultative me secilin drejtor të programeve buxhetore të komunës. Qëllimi i këtyre takimeve është të kuptohen arsyetimet për programet e reja / iniciativat rreth politikave si dhe kostos indikative,
5. Kompletimi dhe dorëzimi i kërkesave fillestare në Drejtoratin për Buxhet dhe Financa- Sektori i Buxhetit deri më: **29.05.2025, Forma-Formulari për plotësimin e kërkesave buxhetore do t'u shpërndahet programeve-nënprogrameve buxhetore menjëherë.**

6.Fazat e përgatitjes së KAB-it 2026-2028:

-Fillimi i Qershorit Draft-KAB-i 2026-2028,

-Mesi i Qershorit konsultimet (Bordi i Drejtorve, Komiteti për Politikë dhe Financa, Qytetarët dhe Kuvendi i Komunës),

7. **30 Qershori** është afati i fundit për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale (KAB-it) në Kuvendin e Komunës, dhe dorëzimi në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve.

Ju falënderojmë për bashkëpunim.

Me respekt!